




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vërtetimi: Nr. K-03/25

Data: 08.04.2025

Duke u bazuar në nenet 11, 13, 15, 17, 16, 17, 18.1, dhe 18.2, 25 paragrafi 1 me nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës me datë: 08.04.2025, nxjerr këtë:

Vërtetim

Me të cilin,

I. Konsiderohet i lejuar Përqendrimi i ndërmarrjeve bazuar në nenin 18.1 dhe 18.2 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët nga ZA& SVET nëpërmjet blerjes dhe marrjes së kontrollit të vetëm nga KF Finance mbi INSURE Invest, družba za investicije,d.o.o.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datë; 06.02.2025, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 65/25-11/H, lidhur me Njoftimin e Përqendrimit, të cilin e përfaqëson Znj.Blerina Ramaj Përfaqësues Ligjor, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët nga ZA& SVET nëpërmjet blerjes dhe marrjes së kontrollit të vetëm nga KF Finance mbi INSURE Invest, družba za investicije,d.o.o.

Njoftimi për Përqendrim, është i bazuar në Marrëveshjen e blerjes së aksioneve të nënshkruar me 14 Nëntor 2024, ndërmjet MVNAL dhe Kolpe në cilësinë e tyre si Shitës dhe KF Finance, në cilësinë e Blerësit. Ndërsa më 02.04.2025, Autoriteti i Konkurrencës, ka pranuar Kërkesën për nxjerrjen e Vërtetimit për Lejimin e Përqendrimit, nga ndërmarrja KF Finance mbi INSURE Invest, družba za investicije,d.o.o.

Vërtetimi është i bazuar në nenin 18 (Vërtetimi dhe vendimi për lejimin e përqendrimit) par 1.1. *Përqendrimi quhet i lejuar sepse Autoriteti, mbështetur në dokumentet dhe të dhënat e dorëzuara nga parashtruesi ose në njohuritë që zotëron, ka vlerësuar se përqendrimi i synuar nuk ndalohet me nenin 12 të këtij ligji dhe 1.2. nuk nxjerr konkluzion për fillimin e procedurës së vlerësimit të përqendrimit brenda tridhjetë (30) ditëve pasi pranon kërkesën e plotë për lejimin e përqendrimit.*

Poashtu, Autoriteti nuk ka pranuar komente/ankesë, nga palët e treta bazuar në njoftimin e publikuar në webfaqe, me datë: 26.02.2025. Andaj nga sa më lartë, përqendrimi është miratuar në heshtje.

Palët në Përqendrim:

KF Finance, družba zacenitive in finančno svetovanje, doo, një kompani e themeluar dhe e cila funksionon në përputhje me ligjet e Republikës së Sllovenisë, me adrese të regjistruar në rrugën Verovškova 55A, 1000 Ljubljana, Republika e Sllovenisë, e regjistruar në regjistrin e biznesit të Sllovenisë me numrin e regjistrimit 6579744000 (“ KF Finance”), dhe znj.Miroslava Pirc, shtetase e Republikës së Sllovenisë. KF finance ofron një gamë të gjerë shërbimesh, duke përfshirë vlerësimin e biznesit, konsulencën financiare, bashkimet dhe blerjet, si dhe konsulencë ligjore dhe tatimore. KF Finance është e specializuar në ofrimin e zgjidhjeve gjithëpërfshirëse në lidhje me blerjen dhe shitjen e bizneseve, duke përfshirë analizën e biznesit, ristrukturimin financiar dhe zhvillimin e palëve të biznesit. KF Finance operon në Evropën Juglindore, me zyra në Slloveni, Kroaci dhe Serbi, dhe është e angazhuar në projekte të mëdha si asistim në shitjen e kompanive dhe këshillimi për transaksione të mëdha financiare.

KF Finance është pjese e Grupit ALFI dhe konsiderohen si një ndërmarrje e përbashkët sipas nenit 3 paragrafi 11 i Ligjit të Konkurrencës.

ZA & SVET zavarovalno posredovanje, doo., një kompani brokerimi në sigurime, e themeluar dhe e cila funksionon në përputhje me ligjet e Republikës së Sllovenisë, me zyrën e saj të regjistruar në rrugën Ameriška 2, 1000 Ljublanë, Republika e Sllovenisë, e regjistruar në regjistrin e biznesit të Sllovenisë me numrin e regjistrimit 1806408000 (“ZA & SVET” ose “Kompania e synuar”), nëpërmjet blerjes dhe marrjes së kontrollit të vetëm nga KF Finance mbi INSURE Invest, družba za investicije,d.o.o,

ZA & SVET ofron shërbime gjithëpërfshirëse të ndërmjetësimit të sigurimit dhe menaxhimit të rrezikut për personat juridikë, duke krijuar programe sigurimesh të përshtatura bazuar në analizën e detajuar të rrezikut, nevojat dhe kërkesat e klientëve.



ZA & ZVET nuk ka filiale të regjistruar dhe nuk gjeneron të hyra në Kosovë.

INSURE Invest, družba za investicije,d.o.o., një kompani investimi e themeluar dhe e cila funksionon në përputhje me ligjet e Republikës së Sllovenisë, me adrese të regjistruar në Vrh pri Fari 12, 1336 Kostel, Republika e Sllovenisë, me numër të regjistrimit të biznesit 9623302000 (“INSURE Invest” ose “SPV”), e cila mban 50% të aksioneve në Kompaninë e Synuar. INSURE Invest është e krijuar në vitin 2024 me qëllim përvetësimin e aksioneve në Kompaninë e synuar. INSURE Invest nuk ka aktivitete operationale në treg dhe, përveç mbajtjes së 50% të aksioneve në ZA & SVET, nuk angazhohet në asnjë aktivitet biznesi dhe as nuk ka aksione në ndonjë kompani tjetër. INSURE Invest nuk ka filiale të regjistruara në Kosovë dhe nuk gjeneron qarkullim në Kosovë.

Bazuar në kërkesën e paraqitësit të njoftimit për përqendrim datë 02.04.2025 me Nr. Prot. 158/25-11/H, Autoriteti bazuar në nenin 18.2, lëshon këtë, Vërtetim si në dispozitiv.

AUTORITETI I KONKURENCËS

Neime Binaku - Isufi
Kryetare



Me këtë Vërtetim, të njoftohen:

- Paraqitësi i Iniciativës
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva